



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY  
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 29-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.07.2020 (e Enjte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                           |                               |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;      | 14. Ardita Idrizaj, AAK;      |
| 2. Zenel Shatri, LDK;     | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK;     |
| 3. Besa Ferati, LDK;      | 16. Labinot Aliaj, PDK;       |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;    | 17. Arben Kabashi, PDK;       |
| 5. Njomza Demaj, LDK;     | 18. Ajshe Metaj, PDK;         |
| 6. Haki Podrimaj, LDK;    | 19. Mirushe Sadikaj, PDK;     |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK;  | 20. Agron Avdijaj, VV;        |
| 8. Ruzhdi Metaj, LDK;     | 21. Lavdije Bujupaj, VV;      |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK;   | 22. Arif Elshani, IQ;         |
| 10. Naim Imeraj, AAK;     | 23. Radoš Repanović, SL;      |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | 24. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Misin Berisha, AAK;   | 25. Slaviša Maliković, SM.    |
| 13. Eliot Kukiqi, AAK;    |                               |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm Kryetari Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të mediave, zyrtarë të tjerë administrativ (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 29-të të rregullt, të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

### **Rendi i ditës**

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2020,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Kodin e Etikes për zyrtarët e Komunës së Istogut.
6. Shqyrtimi i raportit të punës për 6 mujorin e NP "Ambienti"
7. Shqyrtimi i Raportit dhe analiza e vitit shkollor 2019-2020,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për Ri-alokimin e mjeteve të kategorisë ekonomike shpenzimeve kapitale (fondi burimor 10).
9. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

### **Shqyrtimi i pikës 1**

**Kryesuesi**, njoftoi se në mbledhje munguan 2 (dy) anëtarë të Kuvendit ndërsa 25 (njëzet e pesë) janë prezentë në mbledhje.

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Kryesuesi**, Arsyetimi i mungesave, në mbledhje munguan Valbona Demaj, me arsye, dhe Riza Dreshaj nga i cili nuk kemi ndonjë informatë.

Pyes anëtarët e Kuvendit nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës, pasi që askush nuk u lajmërua, hedh në miratim rendin e ditës:

### **Kuvendi unanim miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje**

**Kryesuesi**, këtu para miratimit është dashtë ndoshta po kërkoj falje, por ne e kemi një pikë të rendit të ditës Ri-alokimi i mjeteve buxhetore, por paraprakisht do t'i shtojmë këtij Ri-alokimi edhe një pikë nga Drejtorati i Arsimit që besojë që nuk është në kuadër të kësaj pike kërkesa e tyre që besojë do të paraqitet gjatë takimit, si njoftim.

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Kryesuesi**, aprovimi i procesverbalit të rendit të ditës, pyes anëtarët e Kuvendit a ka dikush diçka në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? E keni marrë në material, nëse ka dikush ndonjë vërejtje, apo ndonjë sugjerim le të urdhëron?

Nuk është lajmëruar askush. Atëherë pyes anëtarët e Kuvendit kush është për që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

**Konstatohet se Kuvendi unanimit miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar të datës 30.06.2020.**

### **Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi**, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ashtu qysh edhe kemi biseduar dhe konsultuar paraprakisht me Kryetarin, na raporton ZKF, z. Osman Sadikaj.

**ZKF, Osman Sadikaj**, z. Kryesues faleminderit për fjalën, përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe prezanton raportin për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2020.

**Kryesuesi**, faleminderit i nderuar Osman Sadikaj!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit e dëgjuat prezantimin për këtë raport tre mujor financiar të buxhetit nga Zyrtari kryesor financiar, nëse dikush e dëshiron fjalën nga anëtarët e Kuvendit le të urdhëron?

Nuk është lajmëruar askush, ky është një raportim i Kuvendit prandaj nuk votohet.

### **Shqyrtimi i pikës 5.**

**Kryesuesi**, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kjo Rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, deri në këtë moment ku edhe duhet ta aprovojme ose mos ta aprovojme. Unë lidhur me këtë ja kisha bartë fjalën Drejtorit të Drejtoratit për Zhvillim Lulzim Blakaj, i cili ka qenë edhe anëtar i komisionit dhe kështu jemi marrë vesh ta prezantojë këtë pikë të rendit të ditës para jush.

**Kryetari**, kush ka qenë kryetar i komisionit?

**Kryesuesi**, ka qenë drejtoresha e Administratës Publike, por nuk është prezentë këtu.

**Lulzim Blakaj**, përshëndet të pranishmit, dhe prezanton Projekt-Rregulloren për Kodin e Etikes.

**Kryesuesi**, faleminderit drejtor!

Të nderuar anëtar të Kuvendit e dëgjuat, e përmendi edhe drejtori është edhe një rekomandim që e keni pas në material nga KPF-ja i cili është nxjerrë bazuar në propozimet që janë dhënë gjatë diskutimit publik.

Nëse dikush dëshiron fjalën.

**Arben Kabashi** është lajmëruar, urdhëro?

**Arben Kabashi**, përshëndet të gjithë të pranishmit!

Jemi te Rregullorja, pra Projekt-Rregullorja, i kam disa propozime, po ashtu edhe riformulime në kuadër të neneve. Unë së pari po filloj te neni 8 ku thotë: zyrtari i Komunës duhet të përgjigjet me transparencë dhe vërtetësi çdo kërkesë nga media për informacion lidhur me kryerjen e detyrave por nuk duhet të ofrojë informacione konfidenciale dhe informata lidhur me të dhënat personale siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi. Atëherë propozim për sqarim është kjo: Sipas praktikave të deritanishme në zbatim për media është prononcuar vetëm Zyra për Informim e Komunës dhe drejtorët e Drejtorive. Tash shkojmë te neni i lartcekur, a i lejon secilit zyrtar të prononcohet, pra kjo të riformulohet në një lloj forme, çdo zyrtar të cekur brenda këtij ligji brenda këtij neni 8 të prononcohet për media.

Te neni 24 pika 1, zyrtari i komunës për punësim apo angazhim në aktivitet të jashtëm duhet të njoftojë dhe kërkojë leje paraprakisht nga udhëheqësi drejtues, të informoj autoritetin përgjegjës në institucion.

Atëherë propozimi im është t'i shtohet pra zyrtarit të Komunës për punësimin apo angazhimin për aktivitete të jashtme, pra kërkojë që të shtohet në orarin zyrtar brenda orarit të punës apo kjo vlen veç jashtë orarit të punës. Neni 24 pika 1 ku thotë zyrtari i Komunës për punësim apo angazhim në aktivitet të jashtëm duhet t'i njoftojë dhe kërkojë leje paraprakisht nga udhëheqësi drejtues, të informoj autoritetin përgjegjës në Institucion. Atëherë propozimi është në orarin zyrtar të punës t'i shtohet brenda orarit të punës, apo jashtë orarit të punës të marrë leje. Po te i njëjti nen, neni 24 te pika 2, ku thotë punësimi ose kryerja e veprimtarive private nga zyrtari i komunës, jashtë orarit zyrtar të punës lejohet, vetëm nëse nuk është në kundërshtim me funksionin zyrtarë. Unë kisha kërkuar këtu që të shtohet a është në pajtim me ligjet në fuqi dhe nuk kërkohet leje nga udhëheqësi drejtues.

E kam edhe një koment në kuadër të nenit 24 ku propozojë riformulim d.m.th. ku do të përcaktohej që çdo zyrtarë për punë të jashtme të orarit për punën e jashtme jemi tu fol çdoherë, që nuk është konflikt interesi, mund të ushtrojë profesion pa pasur nevojë për leje nga udhëheqësi drejtues. Neni aktual në mënyrë indirekte e mohon ushtrimin e funksionit jashtë orarit të punës në pajtim me ligjin e Punës.

Te neni 32 dhe 33 te masat disiplinore unë kisha propozuar pra propozim për plotësim, në këto 2 (dy) nene që kanë të bëjnë me zbatimin e Kodit të Etikës në asnjë rast nuk është paraparë e drejta e ankesës të zyrtarit komunal në masat e shqiptuara disiplinore ku i mohohet e drejta e ankesës, është në kundërshtim me ligjet në fuqi që garanton të drejtën për ankesë. Pra propozojë që te ketë një pikë te këto 2 (dy) nene, për drejtën e ushtrimit të ankesës nga zyrtari.

Faleminderit z. Kryesues!

(anëtari i Kuvendit, Arben Kabashi ku është duke cekur nenin 24 pika 1, faktikisht është duke folur për pikën 2, dhe po ashtu te po i njëjti nen e cek pikën 2 që në fakt është pika 5 e po këtij neni)

**Kryesuesi,** Arben i pate dy propozime më duket a tri?

**Arben Kabashi,** i pata dy propozime po tri ishin riformulime.

**Kryesuesi,** drejtori Lulzim Blakaj e ka kërkuar fjalën.

**Lulzim Blakaj,** kështu sa i përket nenit 8 është e përcaktuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm të punëve dhe përgjegjësi të Administratës Komunale. Në këtë rregullore të cilën e ka nënshkruar Kryetari i Komunës janë të përcaktuara në mënyrë decitive përgjegjësitë e secilit zyrtarë i cili ushtron punë dhe përgjegjësi në kuadër të kontratës të cilën e ka nënshkruar. Do të thotë raporti me publikun është punë ekskluzive e Kryetarit, mirëpo e cila i është deleguar Zyrës së marrëdhënies me publikun do të thotë zëvendëses së Komunës. Ekziston mundësia që për punë të caktuar, për ndonjë çështje të caktuar Kryetari i Komunës ta autorizojë ndonjë zyrtarë i cili ka njohuri më të afërta për atë çështje, për të cilën janë të interesuara mediat. Mirëpo si do që të jetë komunikimi është i organizuar në formë të rregulluar me organizimin e brendshëm dhe strukturimin me organet e administratës. D.m.th. kjo është sa i përket asaj. E lejon, nëse Kryetari e lejon, tjetër askush nuk mundet, në të kundërtën bën shkelje, pason përgjegjësia disiplinore.

**Kryetari,** këtu po thotë qartë, ka të drejtë Arbeni që e bën pyetjen, këtu thotë zyrtari i Komunës i përgjigjet çdo kërkesë të publikut në lidhjen me kryerjen e detyrave, këtu askund nuk e përmend Kryetarin e Komunës, askund nuk e përmend Zyrën e Informimit, askund nuk e përmend Zyrën për marrëdhënie me publikun. Do të thotë zyrtari sipas kësaj Rregullore paska të drejtë t'i përgjigjet publikut në çdo rast

kur ai konsideron. Kjo nuk është e mirë. Unë e di që këta e bëjnë, unë e di që zyrtarët komunal e bëjnë fshehtas, bile mos ta bëjnë me Rregullore a po kupton.

**Lulzim Blakaj**, është çështje e komunikimit me mediat.

**Kryetari**, po për media jam duke fol. Shiko ku e ki të qartë zyrtari i Komunës duhet të përgjigjet me transparencë dhe vërtetësi çdo kërkesë nga media, d.m.th. çdo kërkesë e bërë zyrtarit komunal, shërbyesit civil ky duhet me ju përgjigj. Pse? Kjo nuk është e bazuar në ligj unë në fund të fundit kjo Rregullore le të jetë çfarëdo, unë jam i obliguar me e zbatuar ligjin. Ky është ai problemi im, nuk kam ndërhyrë në këtë se e di se si ka filluar me u punuar kjo. Kodi i Etikës' vet emri Kodi i Etikës, kur flasim për etikë edhe e përmendim fjalën 'kod, e kodi është ligj, e etika nuk mund të jetë ligj, në etikë nuk ka ligj ajo varet prej etikës prej sjelljeve morale etike që mund të i ketë një shërbyes civil në raport me qytetarin me punën të cilën e kryen d.m.th. ajo është një lloj përgjegjësie, një lloj etike, një lloj morali, kryhen obligime që i ka si zyrtarë. Atë formën që po don ti me e arsyetuar, atë që po e kërkon Arbeni gabim e ke, gjeje një arsyetim tjetër. Fshije krejt nenin 8, nuk ekziston ai nen, nuk duhet me kanë, ku jeni bazuar që e keni marrë këtë : Çdo zyrtar komunal ka të drejtë me ju përgjigj çdo qytetari në kërkesën e tij, ka obligim me u përgjigj në kërkesën e qytetarit në kuptimin në kërkesë që e ka bërë ai po edhe ajo e ka rregullën e vet. Mirëpo të pyet ai gazetari atje në media, vjen ky djali këtu p.sh edhe shkon ku di unë një zyrë edhe thotë tregomë ti mu çka është ka bëhet këtu? Edhe nuk ke nevojë, nuk kemi ne dokumente konfidenciale, janë të kategorizuara ato cili është dokumenti jonë konfidencial është e paraparë me ligj, krejt dokumentet nëpër lëndinë i kemi mirëpo duhet me ditë kush i zbulon, jo çdo zyrtar.

**Lulzim Blakaj**, Kryetar në nenin 8 në fund është duke respektuar kufizimet në lidhje me dhënien e informacioneve sipas ligjit, i ka të kufizuara ai, do të thotë ai mundet me jap informacione procedurale në pikëpamje qysh e përcakton ligji për procedurën, sa i përket procedurës, jo për çështje që kanë të bëjnë me kërkesën me vendosjen për kërkesë ose ndonjë informacion tjetër.

**Kryetari**, dëgjo a bie ndesh me Ligjin mbi qasjen e dokumenteve zyrtare?

**Lulzim Blakaj**, ajo është tjetër, ne e rregulluam është një lëmi tjetër.

**Kryetari**, nëse jep informacione duhet me dhënë informacionin në bazë të dokumenteve që ekzistojnë a bie ndesh kjo, zyrtari komunal që jap informacionin?

**Lulzim Blakaj**, nuk guxon, se e ka të kufizuar në lidhje me dhënien e informacionit sipas ligjit. Këtu menjëherë i delegon te Ligji për Qasje në dokumente zyrtare, është

ligji tjetër tani, Rregullorja për klasifikimin e dokumenteve zyrtare që ende nuk i kanë sjell ata grupacionet të cilat janë dokumente zyrtare sekret tepër sekret, që në faktikisht në komunë nuk kemi ndonjë sekret që nuk mundemi me dhënë, si do që të jetë mundet me u riformuluar neni 8.

**Kryesuesi**, neni 8 pika 1 është për diskutim?

**Kryetari**, jo pika 1 edhe 3,

**Lulzim Blakaj**, po edhe 3 është.

**Arben Kabashi**, po se këtu po thotë zyrtari i komunës, d.m.th. çdo kush mundet me qenë zyrtar i komunës a po kupton, mund ti përgjigjet me transparencë, çdokush mundet me kanë prej kabinetit të ekzekutivit zyrtar. Nuk është e specifikuar se kush ka të drejtë.

**Lulzim Blakaj**, dëgjo zyrtar i komunës janë të përcaktuara përkufizimet këtu, janë zyrtari politik, zyrtari publik, zyrtari i komunës përfshinë të gjithë të punësuarit në Komunë, si në paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni. Do të thotë këtu i ka përfshirë të zyrtarët e komunës, i ka përfshirë shërbyesit civil, që ndahen edhe shërbyes civil që është e rregulluar, fatkeqësisht ai ligji është hala në Gjykatën Kushtetuese për zyrtarët publik, ligji për zyrtarët publik hala nuk është vendos për të çka do të bëhet edhe tash në bazë të këtij tash edhe ai kur të hyn në fuqi me siguri, po dua me ju sqaruar diçka se kjo Rregullore, ky model i Rregullores është i dizajnuar prej Asociacionit të Komunave të Kosovës, është një model unik për të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës.

**Kryesuesi**, Agron Avdijaj ka kërkuar fjalën.

**Agron Avdijaj**, unë mendoj që secila Rregullore nuk duhet me u pa vetëm në tërësi si Rregullore, se sigurisht është e lidhur edhe me rregullore tjera dhe kompetenca tjera.

Në anën tjetër secili zyrtar po ashtu e ka edhe përshkrimin e detyrave brenda kompetencave të tij, deri në momentin kur e ka një pozicion të caktuar, prandaj unë nuk kisha menduar që duhet me u heq këto, se janë nenet e mëposhtme që e rregullojnë këtë edhe pastaj qasja për dokumente tjera konfidenciale, që transparencë është edhe me i thënë nuk e kam këtë kompetencë me ta jap këtë informacion edhe shkon në nivel tjetër. D.m.th. nëse ai i jap diçka jashtë kompetencës ai bën shkelje ligjore d.m.th. zyrtari përkatës, pavarësisht që kjo Rregullorja e Etikës mundet me ja lejuar, prandaj po shoh që ndoshta nuk është fortë e nevojshme me humbë kohë shumë në këtë pikë po prapë ju e diskutoni. Ndërsa sa i përket Rregullores në përgjithësi unë më shumë shqetësimin e kam gjithmonë te

rregulloret zbatimin e tyre, tek kompetenca mekanizmat e personave që janë përgjegjës për monitorimin vlerësimin dhe zbatimin saj, prandaj unë konsideroj që në këtë drejtim Komuna duhet me u angazhuar më shumë se sa në vet pikat brenda Rregullores, sepse pastaj vështirësitë kryesore na ndodhin në zbatimin e saj në praktikë. Faleminderit!

**Kryesuesi, faleminderit Agron!**  
Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

**Lulzim Blakaj**, te neni 24, a kërkojë ky që kur të angazhohet jashtë orarit të punës të mos kërkoj leje prej eprorit? Pra nëse shërbyesi civil jashtë orarit të punës angazhohet me punë tjetër ose veprimtari që të mos kërkoj leje paraprake prej eprorit, për këtë po e them se është me ligj e rregulluar. Këtu është te angazhimet aktivitetet e jashtme, jo jashtë orarit të punës, të jashtme. Po tregoj e kemi pas një shembull, Kryetari e din kur kem angazhuar, ku na kanë kërkuar prej Ndërmarrjes Publike "Drini i Bardhë" angazhimin e shërbimit të Zyrës së Prokurimit, ne e kemi angazhuar atë me lejen e Kryetarit, e kemi pas një marrëveshje ju ka munguar kuadri atyre, ne e kem ofruar shërbimin që zyrtarët tanë të prokurimit të ju a kryejnë ato shërbimet e prokurimit brenda Ndërmarrjes Publike "Drini i Bardhë" kjo do të thotë që është e jashtme po brenda kuadrit të orarit të punës, por çdo gjë është e rregulluar jashtë orarit të punës ,angazhimi i punëtorëve jashtë orarit të punës është i rregulluar me Ligjin mbi Shërbimin Civil, tash është Ligji për Zyrtarët Publik, ai ligji që i përmban të gjitha këto edhe për shërbyes civil edhe për zyrtarët e tjerë publik ku përfshihen arsimi, shëndetësia të gjitha. Mirëpo ajo është e rregulluar, forma dhe mënyra. Ne mundemi me e bë si definicion qe e rregullon, që angazhimi i delegohet d.m.th. përgjegjësia në bazë të ligjit qysh është e rregulluar.

Neni 24 te pika 2, e ka d.m.th. paragrafi 2 është : zyrtari i komunës për punësim apo angazhim në aktivitet të jashtëm duhet t'i njoftojë dhe kërkoj leje paraprakisht nga udhëheqësi drejtues, të informojë autoritetin përgjegjës në Institucion. Nëse nuk është në kundërshtim me ligjin aktual në fuqi që e rregullon shërbimin civil ose ligjin mbi zyrtarë publik. Tha edhe te neni 32 e drejta e ankesës, nenet 32 edhe 33? Te masa disiplinore këtu i kem të ndara, te masat disiplinore te zyrtarët publik, dhe masat disiplinore sa i përket të zgjedhurit apo të emëruarit politik, tash të emëruarit politik nuk është bërë dy-shkallësia, mirëpo te këta zyrtarët publik është e përcaktuar me aktet nënligjore, ne i kemi shumë akte krahas Ligjit Mbi Shërbimin Civil janë aktet e përgjegjësive dhe masave disiplinore, udhëzimi administrativ për punësimin, është udhëzimi administrativ për veshjen e zyrtarëve publik d.m.th. janë disa akte nënligjore që e rregullojnë në mënyrë të veçantë si sjelljet brenda edhe etikës, mirëpo të ju them të drejtën ky Kod i Etikës, ky është Kod i cili po kërkohet shumë nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, organizatat ndërkombëtare të cilat kërkojnë që edhe Komunitat të kenë një akt të tillë, edhe pse kjo Rregullore nëse e shihni është e përbërë prej shumë edhe prej Ligjit mbi Konfliktin e Interesit edhe për

Ligjin për Kodin Etik, edhe Ligji për Shërbimin Civil edhe shumë ligje të tjera që janë të përmbledhura në këtë Rregullore. Për ata po them që kjo na është kërkuar si kriter që duhet ne ta plotësojmë. E sa i përket tash te ju këtu, cili është Organi i shkallës së dytë që kishte me vendos për juve,? Brenda juve të formoni një komision tjetër që kishte me rishqyrtuar atë vendim të shkallës së parë. Është e njëjtë po them mundem me e bë analog sikurse te Rregullorja për bursat, komisioni për bursa që formohet pastaj komisioni i ankesave për bursa që vepron në kuadër të Kuvendit.

**Kryesuesi**, dikush tjetër nuk e ka kërkuar fjalën, atëherë na mbetet me këto propozime diskutime që u thanë në nenet 32 dhe 33 u propozua të shtohet e drejta e ushtrimit të ankesës, ky ke një propozim i Arbenit? A pajtohen anëtarët e Kuvendit që ky propozim të futet në këtë Rregullore në nenin 33 si pikë? A jeni dakord të gjithë?

**Konstatohet** që ky propozim nga ana e anëtarit Arben Kabashi, futet në Rregullore nga ana e Kuvendit në mënyrë unanime.

**Kryesuesi**, u përmend këtu një plotësim drejtor, brenda orarit të punës të shtohet a ishte kjo fjali brenda orarit të punës? A pajtohen të gjithë që edhe këtu në nenin 24 pika 2 të shtohet “ brenda orarit të punës” në këtë paragraf, a pajtohen të gjithë anëtarët e Kuvendit me këtë?

**Konstatohet** që gjithashtu edhe ky plotësim futet në Rregullore nga ana e Kuvendit në mënyrë unanime.

**Kryesuesi**, kemi edhe te neni 8 që e shtjelluam pak më shumë. Këtu me sa unë u mendova që nenin 8 pika 1 mund edhe të hiqet krejt, edhe ashtu po tingëllon edhe nuk është në rregull me kërkesë të publikut, me mirë të zyrtarit ose qytetarit në bazë të kompetencave të tij, veç fjala e publikut po mendojë është e tepërt.

**Kryetari i Komunës**, kryesues një sqarim, nuk e kam idenë me mbyll diçka me dalë jo transparent, unë e thashë edhe një fjali nuk është ideja aty, formulimi nuk më pëlqejë d.m.th. mundet me u bë pak ma mirë, le të del unë thashë kështu pak me ironi kështu që nuk mund ja ndali një zyrtari komunal të jap informacione kujtdo qoftë mediave, nuk mund ja ndali, nëse i jep të gabueshme atëherë jep përgjegjësi tjetërkund. Mirëpo mua më dukej që binte ndesh aty njëra me tjetrën.

**Lulzim Blakaj**, duke marrë parasysh sugjerimet e Kryetarit, mendimi im është që të hiqet paragrafi 1 dhe paragrafi 4, që kanë të bëjnë në raport me mediat. Edhe do të thotë informimi për media i zyrtarit publik është i rregulluar me Rregulloren për Organizimin e brendshëm të Komunës. A këto dyja unë mendojë që duhet me mbet d.m.th. paragrafët 2 dhe 3 se e përcakton raportin me qytetarë dhe kolegë të vet zyrtarë.

Paragrafi 1 dhe 4 të hiqen e të jetë një paragraf 3 tash kjo informimi për media i zyrtarit bëhet në pajtim me Rregulloren e brendshme dhe sistematizimin e punëve të Komunës nëse pajtoheni?

**Kryesuesi**, e dëgjuat propozimin e drejtorit njëherësh edhe anëtarit të komisionit për hartimin e kësaj Rregullore. Pra kemi propozimin pas këtyre diskutimeve që në nenin 8 paragrafi 1 dhe 4 të hiqen e të shtohet një paragraf 3. Atëherë a jeni dakord anëtarë të Kuvendit që të bëhet ky ndryshim në këtë Rregullore sipas propozimit që u dha, a pajtoheni të gjithë, kush është për?

**Konstatojmë që me 22 vota për 1 kundër dhe asnjë abstenim futet ky ndryshim në Rregullore nga ana e Kuvendit.**

**Kryesuesi**, atëherë na mbetet që të procedojmë votimin e Rregullores komplet me këto ndryshime që i potencuam. Pyes anëtarët e Kuvendit kush është që të miratohet Projekt Rregullorja për Kodin e Etikës për zyrtarët e Komunës së Istogut me këto ndryshime që u votuan tash. Kush është për miratimin e saj?

**Konstatojmë që kjo Rregullore për Kodin e Etikës për zyrtarët e Komunës miratohet në mënyrë unanime nga ana e Kuvendit.**

**Kryetari**, kërkon falje që duhet të largohet nga mbledhja për shkak se ka një takim me disa investitorë, dhe shfrytëzon rastin të urojë Festën e Kurban Bajramit për të gjithë të pranishmit.

## **Shqyrtimi i pikës 6.**

**Kryesuesi**, të nderuar anëtar të Kuvendit vazhdojmë me tutje.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, këtu nuk e kemi Drejtorin e Ndërmarrjes Publike "Ambienti" por e kemi Drejtorin e Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Gatishmëri Emergjente.

z, Enver Rugova e ka fjalën.

**Enver Rugova**, përshëndet të pranishmit, dhe prezanton raportin për 6 mujorin e NP "Ambienti".

Tash e kemi edhe një kërkesë për Asamblen Komunale të Istogut.

**Kryesuesi**, jo unë e kisha lënë krejt kërkesën!

**Enver Rugova**, mirë po unë desha shpejt me përfunduar!

**Kryesuesi**, jo jo nuk është në material, është raporti, nuk është kërkesa ajo mbetet për më vonë!

**Enver Rugova**, po për kur kryesues? Kërkesën e kanë për me i nivelizuar çmimet në nivel të regjionit!

**Kryesuesi**, Enver mos ta hapim debatin nuk është pikë e rendit të ditës!

**Enver Rugova**, po e kanë dërguar kërkesën kryesues!

**Kryesuesi**, ke mundur në fillim me e propozuar!

**Enver Rugova**, më fal kryesues, nuk po bëj debat me të vërtetë është çështje e tarifimit janë njerëzit në vijë ,dhe është çështje e 4 euro e 80 cent!

**Kryesuesi**, drejtor nuk mund të lejojë se është veç kërkesë nuk është në material, në material është raporti i punës, nuk ka kërkesë, anëtarët e Kuvendit nuk kanë kërkesë për këtë punë, dmth nuk e kanë këtë pikë të rendit të ditës, mund të bisedojmë por nuk është nevoja me e shtruar. Se e di unë se çka ka ndodhë edhe në vende të tjera të lutem. Vazhdojmë më tutje! A e dëshiron dikush fjalën lidhur me raportin e ndërmarrjes?

Është lajmëruar Agron Avdijaj, Labinot Alijaj dhe Arben Kabashi.

**Agron Avdijaj**, faleminderit kryesues, fillimisht sa për saktësim në raport po thotë që është e përfshirë 100 %, në fakt në raport është deri 45 fshatra a din sa për saktësim edhe pse për mua është inkurajuese përfshirja në këtë periudhë kaq të shkurtër e mbulushmërisë e mbledhjes së mbeturinave. Një element tjetër ke interesant te inkasimi, ajo çka kam mundur të shoh edhe që është vështirësia kryesore nganjëherë është në vetëdijësimin e qytetarëve për pagesën e faturave për mbeturinat sidomos edhe bizneseve, mirëpo në Komunën tonë po na ndodhë e kundërta tash, nivelin e inkasimit dhe faturimit më të lartë e kanë ekonomitë familjare dhe bizneset ndërsa niveli institucional është më mbrapa në përqindje sa i përket pagesave, e që do të thotë nuk është mirë as për imazhin e Komunës që të jemi më mbrapa në këtë nivel, kështu që besojë nuk ish dashtë me kanë vlera të mëdha që Komuna me qenë më dobët sa i përket pagesave për mbeturinat se sa vet

ekonomitë familjare dhe bizneset. Pra këto janë dy elementet që desha me i potencuar. Faleminderit!

**Kryesuesi, faleminderit Agron! Labinot Alijaj urdhëro.**

**Labinot Aliaj, përshëndetje kryesues, drejtorë, kolegë asambleistë!**

Unë deshta me e përgëzuar stafin menaxhues për punën që po e bëjnë, faleminderit për një raport të detajuar drejtor, unë e kam vetëm një pyetje, që doja të ja bëja drejtorit në lidhje me rrugën nga Restaurant "Morea" deri në Cerrcë, e cila tash e një kohë ka filluar të shndërrohet në një deponi të mbeturinave. Pyetja ime do të ishte se a kemi ne një strategji për me e ndaluar atë krim po them që po bëhet aty në atë rrugë, d.m.th a kemi një strategji që kishim mundur me e ndaluar që jo me u hedhur më mbeturinat e me u shndërruar në një deponi ajo. Ju faleminderit!

**Kryesuesi, faleminderit Labinot, Arben urdhëro e kërkove fjalën!**

**Arben Kabashi, faleminderit z. Kryesues.**

Unë kur jemi te deponitë ilegale madje edhe i kam shtruar kërkesë Drejtoratit për Shërbime Publike, një deponi që është në qendër të Gurrakocit, në kuadër të qytetarëve që e kam marrë vet e kam dorëzuar, nuk besojë që është shqyrtuar ose është marrë ndonjë hap për pastrimin e asaj hapësire publike që është. Unë kisha kërkuar nga Drejtorati se këtu shkruan janë mirëmbajtur, bashkësia lokale e Gurrakocit thotë u mirëmbajt pothuajse edhe parku, parku ne e dijmë se si është për sivjet as nuk është hy kush në të, kështu që dallon raporti prej punës në terren. Është edhe deponia ilegale aty pothuajse midis qendre në drejtim të kishës që është aty.

**Kryesuesi, të ndërmerren masa për mënjanimin e tyre dmth si vërejtje për të ardhmen.**

**Selajdin Bytyçi e ka kërkuar fjalën, urdhëro Selajdin.**

**Selajdin Bytyçi, faleminderit Kryesues për fjalën.** Në këtë kompani faktikisht ne i përcjellim raportet 6 mujore çdoherë kështu që është një punë e vazhdueshme me ndërrime shumë të vogla. Një rënje shihet këtu në tre-mujorësh të dytë të 2020-tës. Këtu u përmend te institucionet thotë gjatë këtij tre mujori të dytë institucionet nuk kanë punuar, shkollat edhe disa çerdhe, kështu që shihet një inkasim pak më i vogël dmth çështja është aty. Te mbeturinat njësi matëse e mbeturinave është m<sup>3</sup> dmth mos të frikësohen prej këtyre shifrave këto janë m<sup>3</sup> dhe ato të pakonpaktuara dmth kemi 387 m<sup>3</sup> ditore janë 387 m<sup>3</sup> të mbeturinave të pakonpaktuara do të thotë kjo është një sqarim për të gjithë. Njo problem që mbetet për kompaninë është amortizimi i mekanizimit. Amortizimi i mekanizimit është i vazhdueshëm dmth kemi pajisje të hershme të vitit 2000-2001-2010 kështu që ato pajisje bëhen shtrenjtë,

ne si Komunë ndoshta ish dashtë në këtë drejtim pak me menduar edhe me ju ndihmuar kompanive që ta përtirijnë mekanizimin. Një kërkesë për të ardhmen, ndoshta kishte mundur me hy në shqyrtim nga Drejtorati i Arsimit që nëpër shkolla të futet një orë mësimore për ruajtjen e ambientit në mënyrë që fëmijët tonë, nxënësit tonë të krijojnë një kulturë sadopak që ndikojnë në ruajtjen e ambientit në përgjithësi. Dmth nëse te fëmijët tonë ne arrijmë me instaluar një kulturë të mirë dmth krejt këto mbeturina ose këto deponi të vogla ilegale që po shihen ndoshta vet këta fëmijë, këta nxënës kishin me ndikuar që familjet e tyre mos ti krijojnë. Kështu që për të ardhmen kishte me ndihmuar në përmirësimin e gjendjes. Faleminderit!

**Kryesuesi,** faleminderit Selajdin, i pate disa sugjerime, dhe kjo ke si kërkesë kështu për në të ardhmen, sugjerim edhe këtë mund ta quajmë për Drejtorin e Drejtoratit të Arsimit, se unë sa e di në shumë shkolla në fushat e lëmisë zgjedhore, d.m.th. lëndët zgjedhore që i kanë nxënësit, bile në kohët e fundit çdo shkollë pra kemi grupe të nxënësve që si lëndë e zgjedhin Mbrojtjen e mjedisit dhe ambientit, por megjithatë, është më se e nevojshme aty ku nuk është të shtohet. Edukata qytetare e përfshinë por është si lëmi zgjedhore që kryesisht merret me të por nuk është e mjaftueshme asnjëherë sepse po e shohim mjedisin tonë.

**Kryesuesi,** Naim Behlulaj e ka kërkuar fjalën.

**Naim Behlulaj,** faleminderit për fjalën Kryesues. Përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket ndërmarjes ambienti e falënderojmë për përkrahjen edhe për punën që e ka bërë një punë shumë të mirë, qoftë puna në terren qoftë edhe sa i përket raportit. Ndërsa drejtori e përmendi përroin në Rakosh që ka nevojë për një pastrim, është shumë e vërtetë që duhet të pastrohet ai përrua, edhe të vazhdon jo deri në Rakosh por të vazhdojë deri në krye të Uçës se është një lum ose një përrua i njëjtë. Kështu që edhe përveç këtij vazhdimi kërkojmë dhe inkurajojmë Drejtorin dhe Ndërmarrjen "Ambienti" që të vazhdon me inkasimin por edhe me vendosjen e fshatrave siç janë Padalishta, Kërrnina një pjesë Zhakovë, Cerkozë, Syriganë edhe një pjesë e Shushicës po me duket nuk janë të kyçur. Këto janë edhe kërkesa të qytetarëve po është edhe një punë e mirë që po bëhet nga Ndërmarrja "Ambienti" që e përgëzojë për punën por edhe e inkurajojë që të vazhdon edhe këtë projekt te përfundon deri në pastrimin e këtij lumit. Faleminderit!

**Kryesuesi,** Faleminderit shumë Naim. Dikush tjetër a dëshiron me e marrë fjalën? Jo! Atëherë drejtor i pate një dy sqarime më duket urdhëro.

**Enver Rugova,** faleminderit Kryesues. Arben sa i përket asaj thashë me e arrit 100% ti ndoshta nuk më ke dëgjuar mirë, kam thënë me e arrit 100% edhe i tha Naimi ato fshatrat që nuk janë përfshirë akoma për këtë po presim prej Qeverisë japoneze faktikisht është alokuar por ata e kanë buxhetin me 31 mars me atë vitin e ri kinez , i kishin buxhetet me 31 mars, d.m.th. nuk i kanë si ne në fund të vitit, edhe çështja

është vonuar d.m.th. janë 75 mijë euro që faktikisht ne e kemi kërkuar një kamion për mbeturina, me marrjen e atij kamioni në një lloj mënyre ai vjen i ri dhe freskohet edhe mirëmbajtja dhe nuk e kanë telashe, që shihet në raport faktikisht mirëmbajtja e atyre automjeteve të vjetra vërtet po ja u merr atë yndyrën e punës së tyre, edhe mundin e madh që janë duke e bërë, d.m.th. me marrjen e atij kamioni atë donacion faktikisht këta kompletohen me mbuluar 100 %, aty punësohet edhe një vozitës, e 3-4 punëtorë tjerë fizik edhe d.m.th. është në plan ajo. Sa i përket në Gurrakoc aty te ajo deponia ne i kemi të evidentuara në Komunën e Istogut, të mëdha, të mesme dhe të vogla me Gizin gjerman, dmth e kanë me GPS monitorohen prej Prishtine të gjitha deponitë në Kosovë, 22 deponi, edhe jemi ndër Komunat që kemi më së paku deponi në Kosovë, disa komuna janë mundur me i fsheh, ne i kemi zbuluar të rejtat edhe ju kemi treguar, mirë është me ju tregu edhe vjen rasti me na ndihmuar, se me i fsheh edhe pastaj as nuk të ndihmon se nuk e ke paraqitur.

E sa i përket parkut në Gurrakoc, kompania për mirëmbajtjen e hapësirave publike faktikisht është në fazën finale të përzgjedhjes, edhe jemi mundur me gjetur privat, me i paguar në forma të ndryshme, por askush në Gurrakoc nuk kemi mundur me e takuar një njeri që faktikisht për një kompensim do ta kishte kosit dhe do ta kishte pastruar atë park, ajo mbetet tash kompania kur të nënshkruan kontratën e parë te hapësirat publike në Komunën e Istogut do të jetë parku, është e vërtet që është i papërdorshëm për momentin. Sa i përket pyetjes së këshilltarit Labinot Aliaj, vërtet është e dhimbshme ajo çka është duke ndodhur ne aksin prej "Moreas" drejtë lagjes "Maxharraj" andej, është e dhimbshme, edhe në ato kanë hedhur materie inerte , që kanë prishur shtëpia, edhe në gypin që i sjell atë ujërat e shiun që janë të rrëmbyeshme, por tash janë të rrezikuar edhe lagjia "Lullaku" aty se i kanë hedhur mu në gypin që e përçon edhe në anë të epërme se nëse e kish sjell në anën e poshtme vet me kaci e kisha heq, por në anën e epërme nuk ka mundësi me e heq atë, edhe kryesisht i hedhin këta që qesin fasada, këta i hedhin me kamioneta, shkojnë andej rruga e mirë pa asnjë pengesë edhe i deponojnë lartë ose poshtë, vërtetë është e dhimbshme çka është duke ndodhur andej, është vështirë edhe me ekskavator me i mbledh ato në të ardhmen, ajo është se konfiguracioni i tokës e bënë të pamundshme ose e dëmton asfaltin me i mbledh ato, me dorë nuk ka shanse, kështu që kjo është punë e inspektorëve, e policisë Labinot unë nuk po dua me u shfajësuar por edhe unë po e shprehi atë keqardhjen e madhe sepse qytetarë jo vetëm të Istogut e kalojnë atë aks edhe për relaksim prej restoranteve. Sa i përket Naim atij përroit të juaj, aty kur të fillojmë vërtetë duhet me pastruar krejt jo vetëm deri në Uçë, po edhe nën Rakosh ka, e din ti, ne jemi duke i vendosur disa mure mbrojtëse andej ka erozionet në Kërrninë të poshtme kishte mjaft bërllok edhe atje. Nuk po di Selajdin tash ato pagesat ti mirë e dhe, faktikisht shkollat çerdhet nuk kanë punuar nuk e di tash qysh e rregullojmë punën e atyre se tash ato tarifohen, por me një marrëveshje edhe me Drejtorinë e Arsimit edhe drejtoritë tjera, buxheti është i ndarë d.m.th. për ato. Faleminderit!

**Kryesuesi,** faleminderit drejtor! Të nderuar anëtar të Kuvendit, i dëgjuaat edhe ju përgjigjet, sqarimet e drejtorit, a e dëshiron edhe dikush tjetër fjalën lidhur me këtë temë? Është lajmëruar Mirushe Sadikaj, urdhëro.

**Mirushe Sadikaj,** Përshëndetje për të gjithë, unë desha mu lidhur me inkasimin këtu te institucionet e Komunës, është fjala që faturimi këtu është bërë te institucionet që nuk kanë punuar, d.m.th. faturimi është dashtë me qenë më i ulët dhe në këtë mënyrë kishte me qenë fatura me e lartë e inkasimit sepse e dimë që shkollat nuk kanë punuar, d.m.th. deri sa nuk kanë punuar nuk kanë pasur shpenzime atëherë faturimi është i lartë. Tjetër desha me u lidhur me kompaninë e cila merret me rehabilitimin e deponisë, kjo kompani ka shpenzime, këto shpenzime a mbulohen nga kompania lokale a nga kompania regjionale. Edhe diçka desha me u lidhur me pyetjen që e bëri kolegu Labinoti lidhur me gypin që është atje te “Morea” deri te lagjia “Maxharraj” në kohën e investimin diametri i atij gypi ka qenë shumë i vogël edhe është ditur aty çfarë përroi është është dashtë një gyp më i lartë, unë nuk e di sa duhet veç, rruga ka qenë aty kur është ndërtuar gypi ka qenë diametri shumë i vogël.

**Kryesuesi,** fjalën e ka kërkuar drejtori urdhëro.

**Enver Rugova,** faleminderit Kryesues. Faleminderit për pyetje.

Kjo çështja e pagesave e ka bërë komplekse situatën tash, jo vetëm te Ambienti por te tatimi në pronë, te ujërat e të të gjitha, faleminderit për pyetje. U ndal puna e përmbaruesve privat, që këta kanë inkasuar mjaft, ne kemi pasur në raporte edhe 110% të biznesit që kanë paguar dmth me përmbarim, janë liruar një kohë nuk kanë paguar fare, tani mandej Selajdini e tha tre mujorin e dytë kanë filluar pak a shumë me paguar më shumë në fund, ose në fillim ka qenë shkurti fillimi i marsit.

Këto prej institucioneve do të paguhen të gjitha, kurse këto tjerat ata i kanë marrëveshjet me palët, edhe kush nuk i paguan janë përmbaruesit tash prej 18 qershorit faktikisht kanë filluar, sa i përket asaj unë e pata fjalën se më ke keqkuptuar gypi depërtues nën asfalt ka qenë funksional deri tash, tash ishalla nuk bie shi me rrëmbim se për besë ata do ta mbulojë rrugën edhe deri te Llullakët atje ka me ju shkaktuar dëme.

**Kryesuesi,** faleminderit drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

Nuk është lajmëruar askush, e falenderojmë drejtorin për raportimin para jush për rezultatin e Ndërmarrjes “Ambienti” faleminderit edhe prej jush që u angazhuat, I urojmë punë edhe suksese kësaj ndërmarrje të madhe edhe premtojmë edhe ndihmën si anëtarë të Kuvendit në atë çka ne mundemi me e bërë.

## **Shqyrtimi i pikës 7.**

**Kryesuesi**, atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës , Shqyrtimi i raportit dhe analiza e vitit shkollor 2019-2020, lidhur me këtë pikë raporton Drejtori i arsimit Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi**, përshëndet të pranishmit dhe prezanton Shqyrtimin e raportit dhe analizën e vitit shkollor 2019-2020.

**Kryesuesi**, faleminderit drejtor! Të nderuar anëtarë të Kuvendit a e dëshiron dikush fjalën lidhur me këtë? Urdhëro e nderuar anëtare e Kuvendit Jehona Haxhijaj.

**Jehona Haxhijaj**, faleminderit Kryesues. Përshëndet të gjithë të pranishmit.

Unë desha me e marrë një informatë prej drejtorit sa i përket nxënësve të klasave të para, shumë prindër po e konsiderojnë si vit të dështuar pasi që mësimi online për ta ka qenë me shumë vështirësi, kështu që ju si e konsideroni a do të përsëritet ky vit shkollor apo do vazhdojë tutje?

**Hajrush Shoshi**, viti shkollor, asnjë klasë nuk do të përsëritet, është vendim i Ministrisë. Ekziston mundësia që të mbahet ndonjë mësim shtesë edhe për klasët e para kur dalin në klasë të dytë mirëpo, përsëritje të vitit nuk ka.

**Jehona Haxhijaj**, shumë prindër janë ankuar se shumë me vështirësi kanë punuar me fëmijët e tyre.

**Hajrush Shoshi**, nëse humbet viti atëherë është një humbje jashtëzakonisht e madhe për arsimin.

**Kryesuesi**, mire dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

Ajshe Metaj dhe Naim Behlulaj.

Urdhëro Ajshe.

**Ajshe Metaj**, faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë!

Lidhur me mësimin online na raportoi drejtori ne e dimë fare mirë që faktikisht që ka pasur edhe pengesa edhe në pajisjet teknologjike, megjithatë kisha pasur dëshirë me ju drejtuar drejtorit se unë njoh nxënës që kanë pasur pajisje, kanë pasur telefonë por asnjëherë nuk kanë shpreh interesim me marrë pjesë në orë. Pra është çështja a mundet me u studiuar më mirë, nuk është ndoshta edhe krejt çështja e mungesës së mjeteve teknologjike por edhe arsye të tjera. Edhe meqë u konsiderua si vit që ka

kaluar tash i suksesshëm a i pa suksesshëm është ai që ka qenë, a ka ndikuar sa është statistika, a kanë marrë pjesë të gjithë mësimdhënësit në procesin e mësimin online? Edhe për mos më të dhënë mundësi që shumë herë me marrë fjalën a është i paraparë numri i atyre bursave se po shihet që kjo faktikisht është për stimulim për këto shkollat profesionale për shkak se mungon kuadri, edhe dhashtë Zoti të regjistrohen më shumë meqë ata mund ti absorboj tregu i punës, duke e pasur parasysh që orientimet tjera ka janë njerëzit edhe me përgatitje tjera superiore nuk mund të gjejnë vend pune, d.m.th. është plotësisht e qëlluar, vetëm me e ditë sa bursa parashihen me ju ndarë atyre, apo të gjithë atyre që regjistrohen. Faleminderit!

**Kryesuesi**, faleminderit Ajshel! Drejtor a po dëshiron me marr fjalën menjëherë apo po dëshiron me prit mos kanë edhe ndonjë pyetje tjetër ?

**Hajrush Shoshi**, kishte me qenë më mirë nëse isha përgjigjur tani.

Sa i përket mësimin online edhe unë jam shumë i sigurt që ndoshta ka probleme edhe ndonjë mësimdhënës nuk është përgjigj ashtu si duhet, mirëpo Ministria e Arsimit është duke u përgatitur që vitin e ardhshëm ta fillojmë me platforma të veçanta, do ta paguaj Ministria e Arsimit, ku do të monitorohen të gjithë mësimdhënësit deri me datën 5 gusht kemi me e dërguar listën me të gjithë mësimdhënësit që do të marrin pjesë në trajnimin për mësimin online d.m.th. të gjithë mësimdhënësit do të trajnohen për mbajtjen e mësimin online, kështu që thashë më herët që ky vit do të na gjej pak më të përgatitur pak më që të vazhdojmë mësimin përndryshe edhe unë i kam vërejtjet e mia po situata ka qenë asisoj që nuk kemi mundur që t'i monitorojmë të gjithë ku nuk kemi pas një platformë të veçantë. Dikush e ka përdorur Viber-in dikush Facebook-un dikush WhatsApp-in dmth nuk kemi mundur me i monitoruar.

Ndërsa sa i përket bursave, sa kam unë informacione do të ndahen për të gjithë ato vajza që do të regjistrohen në këto profesione.

**Agron Avdijaj**, unë edhe ma shumë në formë sugjerimi, ne e kuptojmë vështirësinë gjatë kësaj periudhe sidomos pas pandemisë e cila e ka vështirësuar procesin mësimorë, dhe këtu natyrisht që nuk është kompetente veç Komuna, por është edhe niveli qendror, është problem i krejt shoqërisë, prandaj në kuadër të kësaj duhet secili prej këndit të vet me e jap kontributin sa të mundet. Mirëpo çka kishte mundur me bo Komuna? Unë mendojë që Komuna kishte mundur me bo një analizë të mësimdhënësve të cilët kanë qenë, sepse janë 3 kategori sipas asaj çka unë kam mundur me e vërejtur. Mësimdhënësit që kanë pasur vullnet, d.m.th. që janë angazhuar maksimalisht në mësimin online, dhe pjesëmarrja e nxënësve tek ata mësimdhënës ka qenë më e madhe, është kategoria e mësimdhënësve që kanë pasur probleme me njohuritë teknologjike e që edhe këtu besoj që Komuna me pa pasur interes kishte mundur pak përmes ndonjë asistenti d.m.th. me i inkurajuar mësimdhënësit, edhe është kategoria tjetër e mësimdhënësve të cilët nuk kanë pasur interesim fare për me u angazhuar në këtë drejtim sepse paga ju ka dalë dhe e kanë

marrë si të mirëqenë, konsiderojë që ju si Drejtori duhet ndoshta që besoj keni mekanizma që me bo një evidentim të tillë pak a shumë sado kudo me i pas informacionet sepse mbi bazën e këtyre informacioneve e dini qasjen e juaj ndaj këtyre mësimdhënësve.

**Hajrush Shoshi**, po për këtë shkak Ministria e Arsimit ka kërkuar çdo mësimdhënës e ka dosjen e vet që e ka dorëzuar në drejtori të shkollës, dhe tani sigurisht që do të bëhen edhe këto vlerësime, mirëpo për mua më shumë është më rëndësi që viti i ri shkollor të fillojë në mënyrë të duhur edhe që do të jenë të gjithë në monitorim. Nuk ka me pas mundësi të thotë dikush që e kam mbajtur orën e mos me e mbajtë, d.m.th. do ta keni në monitorim të përgjithshëm, dhe sanksionet do të jenë se ata janë në marrëdhënie pune, si në shtëpi si këtu kanë marrëdhënie pune mirëpo është dashtë me e diskutuar mësimi online të mbahet edhe prej klasave d.m.th. që të sigurojnë pajisjet që në shkollë të vijnë mësimdhënësit edhe të mbajnë mësimin online ose ka variante që vijnë gjysma e nxënësve një ditë dhe gjysma një ditë por jemi duke e pritur shumë shpejt një udhëzim administrativ që është duke e përgatitur Ministria e Arsimit.

**Kryesuesi**, faleminderit drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Mirushe Sadikaj është lajmëruar, urdhëro Mirushe, pastaj Naim Behlulaj ka kërkuar fjalën.

**Mirushe Sadikaj**, e dimë që drejtori i ka statistikën në përgjithësi të numrit të nxënësve që janë regjistruar si në gjysmë vjetorin e parë ashtu edhe të dytë, mirëpo ne këtu nuk e kemi një statistikë të nxënësve sa janë regjistruar cili ka qenë suksesi i nxënësve si në gjysmë vjetorin e parë ashtu edhe të dytë. E sa i përket mësimin në distancë që është mbajtur online gjithë profesorët kanë pasur pengesë javën e parë deri javën e dytë më së shumti, në përgjithësi pastaj kanë mundur me e përvetësuar edhe me pas njohuri mbi teknologjinë sidomos në shkollën profesionale "Mithat Frashëri" pothuajse në përgjithësi kemi pasur njohuri sepse ka pasur shumë profesorë të përgatitur në atë drejtim edhe nuk kemi pasur pengesa, pengesa kanë pasur vetëm teknologjia që nuk kemi pasur kompjuter ose laptop te disa profesorë deri sa i kanë siguruar, edhe ata që i kanë pasur, nuk kanë qenë fort të përdorshëm sepse ne më vonë e kemi përdorur një metodë, një program tjetër d.m.th. kemi kaluar nga Zoom' në Microsoft Teams' si program ka qenë pak më i mirë, edhe këtu kemi pasur pak problem se është dashtë menjëherë me pas laptop të tjerë sepse nuk kanë funksionuar, edhe nuk po e di pse edhe pse ne si shkollë e kemi aprovuar atë program të veçantë edhe e dimë që duhet me pas statistika se sa nxënës kanë marrë pjesë në mësimin online e sa jo, se siç e tha kolegja shumë nxënës kanë pasur telefona por nuk kanë marrë pjesë, nuk e di pse, ndoshta neglizhenca e prindërve të tyre, gjithë është dashtë me u angazhuar prindërit më shumë sidomos në klasat e ulëta se sa të lartat. E mësimi mendojë që ka qenë në rregull d.m.th. është mbajtur rregullisht, vetëm kur kemi pasur mungesë të rrymës ose të rryetit, në këtë mënyrë nuk kemi statistika, mua po më duket një raport i shkurtër edhe pse e di që nuk i keni të gjitha statistikën. Edhe një gabim teknik po më duket këtu që mësimi në

distancë për moshat 0-6 vjeç është mbajtur deri me 31.07.2020 a është kështu, apo është 31.05.2020?

**Hajrush Shoshi**, e kanë statistikën, është e përfunduar e gjitha, mirëpo çështja e çerdheve, çerdhet shumë pak kanë punuar pasi është marrë ai vendim, kështu që këtë deri me 31 të këtij muaji kanë pasur me vazhduar me mësimin online, mirëpo tashmë është lejuar nga Ministria që të hapen çerdhet, kështu që jemi në konsultim me Ministrinë që a do t'i hapim gjatë muajit gusht a po jo, sepse gushti është pushim i rregullt që ju takon. Ndërsa platformën që e kanë përdorur shkollat teknike pastaj edhe gjimnazi është inkuadruar kjo është platformë e Ministrisë së Arsimit, ku ata e bëjnë pagesën, ata e mirëmbajnë po tash kanë duke menduar që çdo nivel i arsimit ta ketë së paku platformën e njëjte në krejt Kosovë. Ju thashë besoj që do të kemi edhe trajnime, trajnimi për kurrikulë ka vazhduar e kanë mbajtur këto ditë dy grupe kështu që ai projekt është duke vazhduar edhe trajnime të tjera kush ka. Një njoftim sa i përket bursave janë kryer të gjitha procedurat d.m.th. janë zotuar mjetet, janë bërë listat mirëpo për shkak se sot është dita e fundit kur Ministria i shpërndanë pagat na thanë që sillni pas Festës së Bajramit edhe menjëherë pas festës do të ekzekutohen, janë 57 bursa të cilat do të ju jepen studentëve, d.m.th. isha duke folur për pagesat e bursave.

**Kryesuesi**, fjalën e ka kërkuar Naim Behlulaj.

**Naim Behlulaj**, faleminderit kryesues! Në radhë të parë desha me i falënderuar krejt mësimdhënësit të cilët kanë dhanë mësim online, që kanë dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm, sepse kanë hasur në vështirësi të shumta, mirëpo e kanë dhanë një kontribut edhe drejtorët e shkollave, edhe drejtorin i cili e ka menaxhuar e ka bërë një menaxhim shumë të mirë të kësaj periudhe. Një pyetje konkrete ishte për drejtorin, ne po kemi pak problem me këta 312 nxënës a sa ishin, a kemi ndonjë plan konkret, në rast se vazhdojmë me mësimin online që të ju ndihmojmë këtyre për shkak të pajisjeve që nuk kanë mundur me u kyç, ose po ka familje që i ka 2 ose 3 nxënës, prindi mundet me ja siguruar 1 ose 2 telefona që të mund të kyçen por më shumë jo. A kemi ndonjë plan konkret ne si Kuvend që mundem me ju ndihmuar këtyre nxënësve? Faleminderit!

**Kryesuesi**, Faleminderit Naim! Drejtor urdhëro.

**Hajrush Shoshi**, thashë që ne kemi filluar edhe donacione që të pranojmë, po presim edhe nga Ministria e Arsimit që së bashku me Drejtorë e kemi bërë një plan që nëse vazhdohet mësimi online të shikojmë sesa kemi mjete buxhetore nga mallra dhe shërbime që të ju ndajmë të gjitha shkollave nga pak, dhe të sigurojmë një fond sadopak simbolik që t'i blejmë edhe ato pajisje shpresojë se do t'i sigurojmë për të gjithë.

**Kryesuesi, urdhëro Labinot!**

**Labinot Aliaj,** desha veç me u ndërlidhë te ajo, d.m.th. po më vjen mirë që jemi ardhë deri te ajo në momentin e fundit që ju bëhen pagesat studentëve për bursa, por mos të harrojmë në Ri-alokim të mjeteve këtu kur Drejtori i Financave z, Hysni Maxharraj, dhe Drejtori i Arsimit thoshin që nuk kemi mjete në fondin prej 10 mijë eurove të dërgojmë për bursa, atëherë Zyrtari Kryesor Financiar thoshte që mjetet janë, d.m.th. kemi ardhur në fund të muajit korrik edhe hala nuk janë pagesat, tash po pritet me u paguar, kjo ke veç një lloj vërejtje që të mos shtyhem e mos të bëjmë inate personale mes veti e t'i lëmë punët keq, d.m.th. qysh atëherë nëse ishin paraparë ato 10 mijë euro e nuk ishin shkuar diku tjetër sot ishin kanë pagesat, ka kaluar gati 1 vit prej kur janë ndarë bursat Kryesues.

**Kryesuesi,** Labinot janë disa procedura, nuk është çështje e inateve këtu nuk besoj, por është dashtë me i prit. Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

Atëherë e falënderoj Drejtorin për prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës, këtë raport pune, edhe ju e dëgjuat!

### **Shqyrtimi i pikës 8.**

**Kryesuesi,** kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës sipas radhës : Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ri-alokimin e mjeteve të kategorisë ekonomike shpenzimeve kapitale (fondi burimor 10.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit e përmenda edhe në fillim kësaj pike të rendit të ditës, materialit që ju e keni aty, me kërkesë të drejtorit në konsultim edhe me Kryetarin i shtohet edhe një pikë d.m.th. edhe një shtesë për Ri-alokim të mjeteve në Drejtoratin për Arsim të cilën do ta rishikon Drejtori i Buxhetit dhe i Arsimit të dytë. Urdhëro fjalën e ka Hysni Maxharraj.

**Hysni Maxharraj,** përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ri-alokimin e mjeteve të kategorisë ekonomike shpenzimeve kapitale (fondi burimor 10.

Një sqarim, hapja e këtyre ofertave është bërë pasi ka përfunduar Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) d.m.th. nuk na është dhënë mundësia për me vendos në pikë të rendit të ditës. Por unë besoj që e keni në konsideratë do të thotë edhe pse jemi me vonesë, atëherë pasi që e kemi të njëjtin pikë, të njëjtin qëllim, të njëjtin Ri-alokim, kërkojë nga ju që të përkrahet edhe ky Ri-alokim nga Drejtoria e Arsimit dhe së bashku me propozimet nga Drejtoria për Shërbime Publike të dërgohet vendimi në Ministrinë e Financave për aprovim. Faleminderit!

**Kryesuesi**, të nderuar anëtarë të Kuvendit veç edhe një here po dua të sqarojë.

E keni pasur në material Propozim -Vendimin e Kryetarit të Komunës për Ri-alokimin që e shtjelloi Drejtori. Nuk e keni pasur në material vetëm një pikë të atij Propozim-Vendimi të ardhur nga Drejtorati i Arsimit e arsyei Drejtori që la ndodhur pasi ka përfunduar mbledhja e (KPF-së).

Ky Propozim-Vendim i Kryetarit do të kompletohet edhe me këtë pikë nga fusha e Drejtoratit të Arsimit, tani do ta shohim a do të miratojmë a jo.

Fjalën e ka kërkuar Agron Avdijaj.

**Agron Avdijaj**, këto bartjet kur po ndodhin është mirë me i cek p.sh që është bartje e mbetur, sepse me fjalë po thuhet e mbetur po këtu tani po ka konfuzion p.sh në material, nuk e di a lejohet kjo a jo, sepse nuk po dihet a po bartet komplet prej një projekti komplet në projektin tjetër, apo bartje që ka mbetur pjesa (teprica) është mirë me u cek që është tepricë, Drejtori e ceku me gojë po në Propozim-Vendim nuk po shkruan, kur po na vjen materiali tani gjatë analizës po kom problem me e ditë se doket shumë e vogël, çfarë projekti është paraparë nuk po e di që është mbetje. Faleminderit!

**Hysni Maxharraj**, Agron faleminderit. Janë disa terma që nuk mundemi me i përdor p.sh "bartjen". Bartjen e përdorim kur bëhet bartja e mjeteve nga të hyrave vetanake nga viti paraprak. D.m.th. këto janë mbetje të projekteve ekzistuese ka qenë shuma 10 mijë euro p.sh e paraparë, ka ofertuar me 8 mijë euro, kanë mbetur 2 mijë euro, atëherë atë mbetje kërkojmë që ta Ri-alokojmë. Ri-alokimi është në kuadër të programit buxhetor d.m.th. kur merren mjetet në Shërbime Publike dhe shkojnë të njëjtat projekte në Shërbime Publike, ndërsa Transferi është nëse i marrim prej një projekti në shërbime publike i dërgojmë në programin buxhetor të Arsimit. D.m.th. duhet me i respektuar këto terma qysh i kërkon Ministria e Financave. Faleminderit!

**Kryesuesi**, faleminderit Drejtor!

Anëtarë të Kuvendit a e dëshiron dikush tjetër fjalën? Jo. Atëherë po e qes në propozim 'Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës plotësuar me këtë pikë që e përmendem. Kush është nga anëtarët e Kuvendit që të miratohet ky Propozim-Vendim për Ri-alokimin e këtyre mjeteve kush është për?

**Konstatohet** që me 18 vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim miratohet Propozim -Vendimi për Ri-alokim të mjeteve në mënyrë unanime nga ana e Kuvendit.

## Shqyrtimi i pikës 9.

**Kryesuesi**, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit diçka lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?

Labinot Aliaj është lajmëruar.

**Labinot Aliaj**, ju kërkojë falje unë vetëm desha një pyetje lidhur me plotësim-ndryshimet e ndarjes së dy parcelave që i keni bo për në Gurrakoc edhe te Parku. Desha me pyet na keni thënë që ndryshimet do të na i dërgoni në email, ndërsa nuk na kanë ardhë në email.

Edhe e kam një vërejtje z, Kryesues shpresojë që pas kësaj jemi në kohë pandemie me dezinfektuar sallën më shpesh pak. Faleminderit!

**Kryesuesi**, të nderuar anëtar veç edhe një minutë, është e vërtetë ajo çka u tha nuk po dua me u arsyetuar kërkoj falje që nuk u a kemi dërguar në email në mënyrë elektronike, tash po u a japim kopje fizike të gjithëve atë ofertë të nënshkruar të Kryetarit me kompanitë e përmendura për të cilat kemi marrë vendim të dhënies së pronës me negocim, dhe mundem me ju informuar që dje është kthyer ligjshmëria por në të vërtetë nuk është kthyer për të dyja përnjëherë, unë besoj se është në procedura se edhe Ministria është pothuajse gjysma e stafit nuk janë në punë, d.m.th. dje për njërin është konfirmuar ligjshmëria dhe është çdo gjë në rregull, unë shpresojë se brenda 2-3 dite do të konfirmohet edhe për tjetrin. Nuk e di pse janë ndarë dhe nuk janë marrë përnjëherë ato vendime. Kaq kisha. Përndryshe sa i përket ofertës ju kërkoj falje që nuk është dërguar në elektronike për ata kam kërkuar edhe me bo kopje edhe me ja u dhënë.

Nëse nuk ka diçka dikush tjetër, po urdhëro Naim Behlulaj e ka fjalën.

**Naim Behlulaj**, një pyetje për Drejtorin e Bujqësisë edhe pse nuk është duhet me qenë këtu drejtori.

**Kryesuesi**, nuk e ka ditë që do të ketë pyetje për të se përndryshe do të vinte, se ai shkoi me Kryetarin na njoftoi qe e kanë një takim.

**Naim Behlulaj**, është bërë një kërkesë prej Jehona Haxhijaj d.m.th. është kërkesë prej fshatarëve që rruga Vojdullë-Uçë është e shkatërruar don me u bë e pakalueshme nëse nuk intervenojnë brenda një kohe të shkurtër ajo do të bëhet e pakalueshme.

**Kryesuesi**, kërkesa është bërë me shkrim?

**Naim Behlulaj**, është bërë kërkesa të martën faktikisht!

**Kryesuesi**, Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?

Pasi që askush nuk u lajmërua, unë e mbylli mbledhjen e Kuvendit dhe ju uroj shëndet së pari këto ditë pak të vështira për të gjithë ,dhe ju uroj festën e Kurban Bajramit. Shëndet e çdo të mirë të gjithëve! Gjithashtu ju uroj edhe të gjithë qytetarëve festën e Kurban Bajramit edhe në emër të juaj!

**Mbledhja përfundoi me punë në orën 12:07.**

**Procesmbajtëse,  
Flora Bujupaj**



**Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Qasim Balaj**

